



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE**

**UDHËZIM**

**Nr. 26, Datë 26.10.2015**

**“PËR  
NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 3.11.2014  
‘PËR ZBATIMIN E REGJIMIT TË VEÇANTË TË SKEMËS SË KOMPENSIMIT TË  
PRODHUESVE BUJQËSORË PËR QËLLIME TË TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR’”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 159, paragrafi 2, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave,

**U D H Ë Z O N :**

Në Udhëzimin nr.19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, bëhet ky ndryshim:

1. Në pikën 3, të nenit 9 të Udhëzimit, paragrafi i fundit ndryshon me këtë përmbajtje:

“Personi i tatueshëm blerës nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin prej 20% të paraqitur në faturën tatimore të lëshuar sipas këtij neni, nëse nuk provon kryerjen e kompensimit të fermerit nëpërmjet likuidimit të vlerës së faturës nga llogaria bankare e tij në llogarinë bankare të fermerit, apo nëse ky likuidim i faturës, nuk është kryer nëpërmjet shërbimit të Postës Shqiptare ”

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**SHKËLQIM CANI**

---

**MINISTRI I FINANCAVE**